



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE**

---

Nr. 3 Prot

Tiranë, më 22.02 2008

VENDIM Nr. 1 dt. 20.02.2008

Në mbështetje të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.02.2008, pasi diskutoi pikën e parë të rendit të ditës mbi gjurmët dhe rrënojat arkeologjike që ndodhen në vazhdim të mureve ekzistuese të kalasë së Tiranës, Rruga “Murat Toptani”

**VENDOSI**

1. Të shpallë “Monument Kulture” gjurmët e reja të Kalasë së Tiranës. Ky vendim plotëson vendimin e vitit 1973, që shpall kalanë monument kulture. Në bazë të nenit 30 të ligjit 9048 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar, KKR i propozon Ministrit të MTKRS shpalljen e gjurmëve të kalasë Monument Kulture.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**  
**PROF. DR. YLLI PANGO**

**SEKRETAR I K.K.R.**

**LORENC BEJKO**